



UNIVERSITETI[®]
METROPOLITAN
TIRANA

UNIVERSITETI “METROPOLITAN TIRANA”

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

MIRATUAR ME VENDIM TË SENATIT AKADEMIK

Nr. 26, Datë 27. 10.2025

Tiranë, 2025



KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Kjo Rregullore mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Universitetit “Metropolitan Tirana”, si dhe në politikat dhe standardet për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Neni 2

Objekti

1. Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e parimeve, mënyrave, rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin “Metropolitan Tirana” (UMT).
2. Rregullorja përcakton gjithashtu kompetencat, përgjegjësitë dhe mekanizmat e veprimit të NJSBC-së, në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe administrative, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 3

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të garantojë ngritjen dhe funksionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si një strukturë e brendshme efektive, e besueshme dhe e qëndrueshme për sigurimin e cilësisë në Universitetin “Metropolitan Tirana” (UMT).
2. Ajo synon të mbështesë vlerësimin e brendshëm, monitorimin sistematik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në veprimtaritë akademike, kërkimore dhe administrative, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira në arsimin e lartë.

Neni 4

Misioni dhe objektivat

Misioni i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin “Metropolitan Tirana” është të mbështesë ndërtimin dhe zhvillimin e një kulture të qëndrueshme cilësie në të gjitha veprimtaritë akademike, kërkimore dhe administrative.



Në përmbushje të këtij misioni, NJSBC:

1. Promovon angazhimin institucional për cilësinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm;
2. Monitoron dhe vlerëson performancën institucionale, duke identifikuar fushat për zhvillim;
3. Mbështet proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit përmes dokumentimit dhe analizës së evidencave;
4. Ofron trajnime dhe asistencë teknike për stafin akademik dhe administrativ në fushën e sigurimit të cilësisë;
5. Harton dhe raporton mbi treguesit e brendshëm të cilësisë, në përputhje me kërkesat institucionale dhe ligjore.

Neni 5

Fusha e veprimit

1. Kjo Rregullore rregullon veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin “Metropolitan Tirana” (UMT), si strukturë e specializuar përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe mbështetjen e proceseve të sigurimit të cilësisë në institucion.
2. Rregullorja zbatohet për të gjitha ndërhyrjet, aktivitetet dhe procedurat që kryhen nga NJSBC në funksion të garantimit dhe përmirësimit të cilësisë në nivel institucional dhe në programet e studimit.
3. Efektet e kësaj Rregulloreje shtrihen mbi veprimtarinë e NJSBC-së dhe mbi bashkëpunimin ndërinstitucional që ajo zhvillon me organet drejtuese, strukturat akademike dhe administrative, personelin dhe studentët, në funksion të realizimit të misionit të saj.

Neni 6

Parimet udhëzuese të veprimtarisë së NJSBC-së

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin “Metropolitan Tirana” (UMT) ushtron veprimtarinë e saj mbi bazën e këtyre parimeve:

1. Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia

NJSBC vepron si strukturë përgjegjëse për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë së brendshme në proceset akademike, kërkimore dhe administrative, dhe raporton për veprimtarinë e saj përpara autoriteteve përkatëse të institucionit.

2. Transparenca

Të gjitha proceset e vlerësimit, analizës dhe rekomandimeve të njësisë janë të dokumentuara, të aksesueshme dhe të hapura për palët e interesuara (studentë, staf, drejtues, partnerë).

3. Përmirësimi i vazhdueshëm

NJSBC nxit dhe mbështet zhvillimin e një kulture përmirësimi të vazhdueshëm, përmes analizave të rregullta të cilësisë dhe përdorimit të instrumenteve të brendshme të vlerësimit.

4. Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse

NJSBC siguron përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara në institucion, përfshirë stafin akademik, stafin administrativ dhe studentët. Gjithashtu, në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, NJSBC angazhon aktorë të jashtëm si punëdhënës, alumni dhe partnerë institucionalë, përmes instrumenteve të strukturuar si anketime, intervista, konsultime ose vlerësime të jashtme mbi performancën e të diplomuarve dhe përshtatshmërinë e programeve të studimit.

5. Autonomia dhe objektiviteti

NJSBC gëzon autonomi funksionale në realizimin e vlerësimeve dhe ushtron mandatin e saj në mënyrë të paanshme dhe të pavarur.

6. Vendimmarrja e bazuar në të dhëna

NJSBC udhëhiqet nga parimi i përdorimit të të dhënave të besueshme, të mbledhura në mënyrë sistematike përmes instrumenteve të brendshëm të vlerësimit cilësor dhe sasior. Vendimmarrja, planifikimi dhe rekomandimet e saj mbështeten në analiza objektive që pasqyrojnë performancën akademike, institucionale dhe përshtatshmërinë e shërbimeve me nevojat e komunitetit universitar dhe të tregut të punës.

7. Përputhja me standardet kombëtare dhe evropiane

Veprimtaria e NJSBC udhëhiqet nga kuadri ligjor dhe standardet kombëtare e evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

KREU II

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI



Neni 7

Përbërja e Njesisë

1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, përfshirë edhe kryetarin, si më poshtë:
 - 3 (tre) përfaqësues të personelit akademik, një nga secila njësi kryesore akademike;
 - 1 (një) përfaqësues i administratës, që është njëkohësisht Drejtuesi i Zyrës së Cilësisë;
 - 1 (një) përfaqësues i studentëve, i cili është Kryetari i Këshillit Studentor;
 - 1 (një) ekspert i jashtëm në fushën e arsimit të lartë ose të sigurimit të cilësisë.
2. Përbërja e NJSBC-së miratohet nga Senati Akademik, në përputhje me Statutin dhe aktet e brendshme të Universitetit Metropolitan Tirana.

Neni 8

Emërimi dhe Mandati

1. Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë miratohet nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.
2. Secili nga anëtarët përfaqësues të njësive kryesore, propozohet nga Dekani përkatës dhe miratohet nga Senati.
3. Kryetari i NJSBC-së emërohet nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.
4. Mandati NJSBC-së është 2 (dy) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

KREU III

KOMPETENCAT DHE DETYRAT

Neni 9

Kompetencat dhe funksionet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Në përputhje me Nenin 103 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” dhe Statutit të Universitetit “Metropolitan Tirana” Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ushtron këto funksione:

1. Harton procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional. Këto procedura miratohen nga Senati Akademik;
2. Zbaton dhe mbështet politikat institucionale për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha veprimtaritë akademike, kërkimore dhe administrative;
3. Harton standardet e brendshme të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe udhëzimet përkatëse;



4. Vlerëson periodikisht cilësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore në njësitë akademike të UMT, në përputhje me standardet e përcaktuara;
5. Kryen studime dhe analiza mbi ecurinë e punësimit të të diplomuarve dhe efikasitetin e programeve të studimit në raport me tregun e punës;
6. Siguron përfshirjen aktive të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm (staf akademik, administrativ, studentë, alumni, punëdhënës) në proceset e sigurimit të cilësisë;
7. Harton dhe administron instrumentet e vlerësimit të cilësisë, përfshirë pyetësorët për studentët, pedagogët dhe aktorët e tjerë institucionalë;
8. Analizon të dhënat e mbledhura nga instrumentet e vlerësimit dhe përgatit raporte periodike mbi performancën akademike dhe administrative;
9. Organizon procesin e vlerësimit nga studentët për mësimdhënien në çdo program studimi, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve;
10. Harton dhe përcjell në Rektorat rezultatet dhe rekomandimet e dala nga vlerësimet dhe analizat e kryera.

Neni 10

Bashkëpunimi me ASCAL dhe proceset e akreditimit

1. NJSBC është përgjegjëse për koordinimin e procesit të vetëvlerësimit dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, në përputhje me kërkesat e ASCAL.
2. Njësia bashkëpunon me organet drejtuese të UMT-së dhe strukturat e brendshme për mbledhjen e evidencave dhe raportimin e treguesve të cilësisë.
3. Ajo përfaqëson institucionin në komunikimet me ASCAL-in dhe ndjek zbatimin e rekomandimeve që vijnë nga vlerësimet e jashtme.

Neni 11

Detyrat e Kryetarit të NJSBC

Kryetari i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është figura drejtuese dhe përfaqësuese e njësisë dhe ka përgjegjësi për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së saj. Ai/ajo ushtron këto detyra:

1. Përgatit planin vjetor të punës së NJSBC-së dhe e paraqet për miratim pranë NJSBC;



2. Planifikon, organizon dhe drejton të gjitha aktivitetet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
3. Përgjigjet përpara Senatit Akademik për realizimin e objektivave të njesisë dhe për çështjet që lidhen me sigurimin e cilësisë;
4. Harton dhe dorëzon raportet vjetore të NJSBC-së, duke përfshirë analizat, rekomandimet dhe përmirësimet e propozuara;
5. Promovon dhe zhvillon kulturën e cilësisë në të gjithë strukturën institucionale, përmes ndërgjegjësimit, trajnimeve dhe bashkëpunimit të gjerë;
1. Siguron që informacioni mbi cilësinë dhe proceset e saj të jetë i dokumentuar dhe i aksesueshëm për të gjitha palët e interesuara. përfshirë studentët, stafin akademik dhe partnerët institucionalë, etj.;
2. Mbikëqyr zbatimin e vendimeve të marra nga NJSBC dhe koordinon bashkëpunimin me njësitë akademike dhe administrative për realizimin e tyre.

Neni 12

Detyrat e përfaqësuesve të fakulteteve në NJSBC

Anëtarët e NJSBC-së që përfaqësojnë njësitë kryesore akademike, përveç detyrimeve të tyre si anëtarë të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), kanë edhe përgjegjësi shtesë në cilësinë e lidhjes ndërmjet NJSBC-së dhe fakulteteve përkatëse. Në këtë funksion, ata ushtrojnë detyrat e mëposhtme:

1. Marrin pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në mbledhjet dhe vendimmarrjen e NJSBC-së;
2. Kontribuojnë në hartimin e planeve të punës, procedurave dhe instrumenteve të vlerësimit të cilësisë në nivel institucional;
3. Përcjellin në mënyrë të vazhdueshme mendimet, propozimet dhe shqetësimet e njësive akademike që përfaqësojnë;
4. Koordinohen me Dekanatin për zbatimin e instrumenteve të vlerësimit të cilësisë dhe për mbështetjen e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë;
5. Ndihmojnë në shpërndarjen, administrimin dhe analizën paraprake të instrumenteve të vlerësimit për stafin akademik dhe studentët në fakultetin që përfaqësojnë;
6. Raportojnë në NJSBC për problematika dhe nevoja për përmirësim në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbime akademike në njësinë përkatëse;
7. Bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të NJSBC-së për hartimin e raporteve vjetore dhe analizave institucionale mbi cilësinë.



Neni 13

Detyrat e Përfaqësuesit të Studentëve

Përfaqësuesi i studentëve në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), përveç përgjegjësi si anëtar i njësisë, ka edhe rolin e garantimit të përfaqësimit të interesave të studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë. Në këtë funksion, ai/ajo ka detyrat e mëposhtme:

1. Merr pjesë rregullisht në të gjitha aktivitetet dhe mbledhjet e NJSBC;
2. Përfaqëson dhe përcjell opinionin e studentëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies, shërbimeve akademike dhe administrative;
3. Merr pjesë në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë;
4. Ndihmon në shpërndarjen dhe administrimin e instrumenteve të vlerësimit të cilësisë (si pyetësorë, formularë etj.) tek studentët;
5. Promovon dhe nxit përfshirjen e studentëve në iniciativat për përmirësimin e cilësisë në institucion.

Neni 14

Detyrat e Përfaqësuesit të Administratës

1. Siguron mbështetje teknike dhe logjistike për realizimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë;
2. Përcjell të dhëna dhe informacione të sakta mbi funksionimin administrativ dhe menaxhial të institucionit që ndihmojnë në analizat e cilësisë;
3. Ndihmon në hartimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit të brendshëm të sigurimit të cilësisë (procedura, formularë, raporte, evidenca);
4. Siguron bashkëpunimin me njësitë e tjera në institucion për qëllime raportimi dhe monitorimi të cilësisë

Neni 15

Përzgjedhja dhe Detyrat e Ekspertit të Jashtëm të Cilësisë

Eksperti i jashtëm i përfshirë në NJSBC, në cilësinë e tij/saj si këshilltar me përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, ka rol mbështetës, vlerësues dhe këshillimor në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane. Ai/ajo:

1. Propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati Akademik për një mandat 2-vjeçar, me të drejtë riemërimi;
2. Duhet të ketë:



- a. përvojë të dokumentuar në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë;
 - b. gradë shkencore / titull akademik së paku “Doktor i Shkencave”;
3. Duhet të jetë i pavarur dhe pa konflikt interesi me institucionin;
 4. Eksperti i jashtëm:
 - a) Merr pjesë rregullisht në të gjitha aktivitetet dhe mbledhjet e NJSBC;
 - b) Ofron asistencë teknike dhe profesionale në përputhje me praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë;
 - c) Kontribuon në trajnime të stafit dhe në auditime të brendshme të cilësisë, kur kërkohet nga NJSBC;
 - d) Siguron analiza dhe opinione të pavarura, objektive dhe të bazuara në evidencë mbi funksionimin dhe përmirësimin e sistemit të brendshëm të cilësisë në institucion;
 - e) Ofron ekspertizë në hartimin e strategjive për zhvillimin e cilësisë, duke propozuar masa për përmirësim të vazhdueshëm dhe përafrim me standardet evropiane të arsimit të lartë.

KREU IV

MBLEDHJET, RAPORTIMI DHE TRANSPARENCA

Neni 16

Mbledhjet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. Mbledhjet e NJSBC-së zhvillohen të paktën dy here në semestër, ose sa herë që kërkohet nga Kryetari i njësisë, Rektori, ose me kërkesën e shumicës së anëtarëve të saj.
2. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili hartohet nga përfaqësuesi i administratës ose një anëtar i caktuar nga Kryetari, dhe miratohet në mbledhjen pasuese. Procesverbalet ruhen dhe arkivohen në mënyrë të rregullt nga Zyra e Cilësisë, në përputhje me rregullat institucionale të dokumentacionit..

Neni 17

Raportimi dhe transparenca

1. NJSBC raporton periodikisht para Rektorit dhe Senatit Akademik mbi aktivitetin e saj, gjetjet kryesore, rekomandimet dhe masat e propozuara për përmirësimin e cilësisë. Raportimi bëhet edhe sa herë që kërkohet nga Senati ose Rektori.
2. Raportet përgatiten nga Kryetari i njësisë në bashkëpunim me anëtarët, diskutohen dhe miratohen në mbledhjen përkatëse të NJSBC-së, dhe firmosen nga të gjithë anëtarët.
3. Të dhënat dhe analizat e nxjerra nga vlerësimet e njësisë ndahen me njësitë akademike dhe administrative për qëllime përmirësimi të vazhdueshëm.

4. Raportet përmbledhëse, analizat vjetore dhe gjetjet kryesore publikohen edhe në faqen zyrtare të institucionit, në seksionin e dedikuar të NJSBC-së, për t'u bërë të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara.

Neni 18

Dispozita përfundimtare

1. Ndryshimet dhe shtesat në këtë rregullore propozohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisionet e Përhershme dhe Rektori dhe hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Universitetit "Metropolitan Tirana"
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe është e zbatueshme për të gjithë strukturat e universitetit.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet çdo akt tjetër me fuqi të njëjtë në Universitetin Metropolitan Tirana, si dhe çdo dispozitë e rregulloreve apo akteve të tjera, që është në kundërshtim me të.